



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 192/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj, për shkak të mbulimit të posterit, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 09.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj.

Arsyetim

Me datën 07.10.2013, subjekti politik LDK, ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendon se, me datë 06 tetor 2013 rreth orës 23:00, Partia Demokratike e Kosovës ka vendosur posterin e kandidatit për këshilltar të Ilir Orllatit, mbi posterin e kandidatit për Kryetar të Komunës Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), të Muharem Svarqes, me të cilin veprim sipas parashtruesit të ankesës është bërë shkelje ligjore e nenit 33. pika a), të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, nenit 3.1.a) të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike dhe nenit 3 të Rr.Zgjedhore Nr.13/2013.

Në cilësinë e provës, parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur ankesës një fotografi si dëshmi.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik PDK, me datën 07.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 08.10.2013 deri në ora 18:00. Sipas afatit të caktuar PZAP-i pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik PDK, lidhur me ankesën Anr. 192/2013, të paraqitur nga subjekti politik LDK, ku theksohet se pretendimet e parashtruesit të ankesës janë të pabazuara, lidhur me nenin 33 pika a të LZP-së, sipas dëshmisë së ofruar posterit të kandidatit të PDK, i vendosur pran posterit të kandidatit të LDK-së, me asgjë nuk e ka cenuar pamjen e posterit, dhe se nuk është mbuluar asnjë shenjë dhe as një shkronjë e posterit të kandidatit të subjektit politik LDK.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore se anëtarët e subjektit politik të PDK, kanë vendosur posterin e kandidatit për këshilltar Komunal Ilir Orllati, mbi posterin e kandidatit të subjektit politik të LDK-së, Muharem Svarqa nuk qëndrojnë ngase dëshmia e ofruar nga parashtruesi i ankesës nuk është dëshmi me të cilën vihet në dyshim se është bërë mbulimi i posterit sipas pretendimeve ankimore, për arsye se nga fotografia e ofruar si provë nga subjekti politik i LDK-së, shihet se është vendosur poster i subjektit politik PDK afër posterit të subjektit politik LDK, mirëpo nuk është bërë mbulimi i posterit në fjalë siç pretendohet në ankesë, andaj PZAP-i konstatoi se një pretendim i tillë është i përgjithshëm dhe i paqartë për vërtetimin e kësaj dëshmie. Prandaj një pretendim i tillë i ankesës u vlerësua si i pabazë, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, neni 3.6 pika b), dhe në kuptim të nenit 115.1, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë

A nr. 192/2013 më datën 09.10.2013.

Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*